

VENDIM
Nr. 29, datë 27.1.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE KUÇOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike Kuçovë”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “drufrutorë”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 374 693 (dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 374 693 (dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh, përballohet nga Bashkia Kuçovë.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Kuçovë.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Kuçovë.
 8. Bashkia Kuçovë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kuçovë.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kuçovë për pasuritë e shpronësuar.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Kuçovë.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kuçovë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE PASURI E PALUAJTSHME PRONË
PRIVATE E TË CILËVE PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE KUÇOVË”

									VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM					
	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE					TOKË ARË			Vlera e kulturave bujqësore dhe drufruturorëve, sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë	VLERA TOTALE	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshat/qytet	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Totale	Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	ÇMIMI (lek/m²)	Vlera (lek)			
1	Fitim	Isa	Çela	Polovine	648/7	2179	Are	4000	4000	268	1072000	766 693	1,838,693	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kuçovë
2	Niko	Dervish	Luzi	Polovine	648/6	2179	Are	2000	2000	268	536 000		536 000	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kuçovë
TOTALI													2,374,693	